




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE



Korçë, me 27.12.2022

**SHPLLJE VENDIMI**

**Drejtuar : Bashkise Maliq**

Per: shtetasin : Sonel Manka, me adrese Pojan Nd. 492  
Pojan 7014 Njesia Administrative Pojan Bashkia Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 736, dt. 31.10.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

**KANCELARE**  
**Lubiana KINOLLI**



U afishua sot ne date -----  
Bashkia Maliq  
Nenpunesi \_\_\_\_\_  
(emer, mbiemer, firme)

-S. Tel. Informacionit  
dt. 05.01.2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇË

Nr.Regj. 21001-01195-41-2022 (1176)  
Datë Regjistrimi 01.09.2022

Nr.Vendimi 41-2022-3293 (736)  
Datë Vendimi 31.10.2022

V E N D I M  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e përberë prej:

**Gjyqtare Luljeta KOLE**

Asistuar nga sekretare Adriana Fero, në Korçë, në datë 31.10.2022, mori ne shqyrtim ne seance gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

**PADITËSE:** **Brunilda Manka**, e bija e Tonin dhe Roza, datëlindja 11.11.1990, lindur në Lezhë dhe banuese ne Pojan, Korçë, me adrese njoftimi prane avokat Petrit Hysi, Dhoma Vendore e Avokatise Lezhë.

**I PADITUR:** **Sonel Manka**, i biri i Bardhyl dhe Ardiana, datelindja 13.04.1991, lindur dhe banues ne Pojan Korçë.

**OBJEKTI:** Zgjidhje martese dhe rregullimi i pasojave qe rrjedhin prej saj

**Baza ligjore:** nenet 132 e vijues të Kodit të Familjes

Ne gjykim e siper te zhvilluar ne mungese te paleve, Gjykata pasi shqyrtoi shkaqet e mosparaqitjes ne gjykim,

**V Ë R E N**

Paditesja Brunilda Manka ka paraqitur ne gjykate kerkesepadi kunder te paditurit Sonel Manka, duke kerkuar zgjidhjen e marteses ndermjet tyre si dhe marrjen e mbiemrit qe ajo ka pasur para martese.

Pas regjistrimit te çështjes, gjykata fillimisht caktoi seancen pajtimore dhe i dergoi te paditurit njoftimin e kerkesepadise dhe provave bashkelidhur te paraqitura nga pala paditese

Në seancën pajtimore të datës 31.10.2022, nuk u paraqit asnje prej palëve, si paditesja ashtu edhe i padituri.

~~Ndersa nga ana e avokatit Petrit Hysi ishte derguar me poste elektronike ne emer te paditeses nje kerkesese per pushimin e gjykimit, duke sqaruar ne kete kerkesese se nga komunikimet me paditesen~~

per njoftimin e dates se seances gjyqesore, ajo ishte shprehur se nuk mund te paraqitej ne gjykim dhe se kerkonte qe çështja te pushohej.

Pas ketij konstatimi, ne rrethanat e mesiperme gjykata çmon se jemi ne kushtet e nenit 179 te K.Pr.Civile, ne te cilin parashikohet "1.Nese asnje nga palet, pa ndonje shkak te arsyeshem, nuk paraqitet ne seance pergatitore ose ne seance gjyqesore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

2.Nese paditesi, pa ndonje shkak te arsyeshem, nuk paraqitet ne seance pergatitore ose ne seance gjyqesore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorezuar deklaraten e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorezuar deklaraten e mbrojtjes, mund te kerkoje vijimin e gjykimit ne mungese te paditesit dhe gjykata, kur vlereson se qendrimi i te paditurit ka shkak te ligjshem, vijon gjykimin ne mungese te paditesit."

Po kështu, duke shqyrtuar kërkesën e paditëses për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin e tij, gjykata çmon se jemi edhe në kushtet e nenit 201 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet "1.Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaraten e mbrojtjes për themelin e çështjes.

2.Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshëm".

Ne lidhje me shpenzimet gjyqesore, ato perbehen nga taksa mbi aktet ne masen 3.000 leke e parapaguar nga paditesja, te cilat ne veshtrim te nenit 106 e vijues te K.Pr.Civile, mbeten ne ngarkim te saj.

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 179/2 dhe 299/b/ç të K.Pr.Civile

### VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile me palë:  
*Paditëse: Brunilda Manka*  
*I paditur: Sonel Manka*  
*Objekti: Zgjidhje martese*  
për shkak të mosparaqitjes të palëve në gjykim dhe heqjes dorë të paditëses nga gjykimi.
2. Shpenzimet gjyqesore mbeten në ngarkim të paditëses sikurse janë bërë.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot në datë 31.10.2022 ora 14:38

**SEKRETARË**  
**ADRIANA FERRO**

**GJYQTARË**  
**LULJETA KOLE**

